




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 20/DPK	Nr. Prot. 01-4912/14
Dep. Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 19.12.2014



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 3545/14, për z. Hajdin Berisha – Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Malishevës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-3545/14, për z. Hajdin Berisha – Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Malishevës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Berisha, është hetuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Komunën e Malishevës dhe njëkohësisht person i autorizuar në Ndërmarrjen “Kosovatrans”.

Zyrtari i lartë fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Berisha, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që të largohet nga personi i autorizuar, dhe ka deklaruar se këtë do ta bëj në afatin ligjor.

Mirëpo ai nuk ka respektuar afatin e dhënë nga shkresa e parë, prandaj AKK i ka dërguar shkresën e dytë “paralajmëruese” me të cilën i ka caktuar një afat të dytë dhe i ka tërhequr vërejtjen se nëse nuk respektohet do të kërkohet shkarkimi i tij nga funksioni publik. Ndërkohë, z. Berisha ka respektuar afatin e dhënë nga kjo shkresë dhe ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 4875/14) me të cilën vërtetohet është larguar nga pozita e personit të autorizuar në Ndërmarrjen “Kosovatrans”. Me këtë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

